



AKT THEMELIMI

I SHOQERISE "SILA" SHPK

Sot, me daten 20.12.2001, une Servet Qazim Caushi, lindur me 1958 ne Fier dhe banues ne Levan Fier, themeloj Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar si ortak i vetem.

NENI 1

Shoqeria Emertohet " S I L A " shpk Import Export.

NENI 2

Selia e Shoqerise eshte me qender ne Levan te rrethit Fier dhe me te drejte per ta ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

NENI 3

Shoqeria ka nje aktivitet te saj ekonomik mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne çdo kohe.

NENI 4

Shoqeria "Sila" shpk ka si Administrator SERVET QAZIM CAUSHI.

Neni 5

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Import Export per tregetin me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial, konfeksjoneve, paisjeve elektrike dhe elektroshtepijake, materialeve te ndertimit, paisjeve hidrosanitare etj.
- Tregetin e automjeteve , Hapjen e serviseve per riparimin e tyre, tregetin e pjeseve te kembimit per to, hapje lavazheve, hapjen e Bar - Buqe e Restoranteve etj.

NENI 6

Kapitali i shoqerise eshte ne natyre 100.000 leke.

ORTAKU I VETEM  
SERVET CAUSHI



S T A T U T I

I SHOQERISE "SILA" SHPK IMPORT EXPORT

FORMIMI

Neni 1

Formohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar e emertuar "SILA", e themeluar nga ortakut i vetem Servet Qazim Caushi, lindur me 1958 ne Fier dhe banues ne Levan te Fierit.

SELIA E SHOQERISE

Neni 2

Selia e Shoqerise eshte me qender ne Levan te Fierit dhe me te drejte per ta zhvilluar veprimtarin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

KOHEZGJATJA

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne çdo kohe.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 4

Veprintaria ekonomike e shoqerise konsiston:

- Import Export per tregetimin me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial, konfeksjoneve, paisjeve elektrike dhe elektroshtepijake, materialeve te ndertimit, paisjeve hidrosanitare etj.
- Tregetimin e automjeteve, hapjen e serviseve per riparimin e tyre, tregetimin e pjeseve te kembimit per to, hapje lavezheve, hapjen e Bar - Bufe e Restoranteve etj.

Neni 5

Shoqeria mund te ndryshoje emerimin, selin si dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marr ortakut i vetem.

*Caushi*

KAPITALI I SHOQERISE

## Neni 6

Kapitali i shoqerise eshte ne natyre 100.000 leke, i formuar ne masese e plote nga ortaku i vetem.

## Neni 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

## Neni 8

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut dhe ato te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperi. Shoqeria fiton zotesin per te vepruar me regjistrimin e saj si person juridik ne Gjykatën e Tiranës dhe ndersa ushtron aktivitetin ekonomik me regjistrimin ne Zyren e Tatimeve Fier.

## Neni 9

Shoqeria ka vulen e saj me permbanjtjen : SHOQERIA "SILA" shpk Import EXPORT.

## Neni 10

Shoqeria "SILA" vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat e detyrimit.

Ajo pergjigjet vet per detyrimet e saj kontraktore e jashte kontraktore brenda kapitalit te saj. Ortaku i vetem mbart rezikun e veprimtarise se shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne shoqeri.

## Neni 11

Shoqeria eshte prone e themeluesit te saj. Ajo merr vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas ketij statuti, te cilat jane te detyrueshme per te gjithë punonjesit ne kete shoqeri.

## Neni 12

Ortaku i vetem, sipas nevojave qe paraqiten, per zhvillimin e veprim-

*Gab*

ntarise se shoqerise , emeron administrator **SERVET QAZIM CAUSHI** dhe puneson punonjes te veprimtarive te ndryshme ekonomike te permendura ne nenin kater te ketij statuti.

#### Neni 13

Ortaku i vetem i shoqerise dhe administratori i ngarkuar prej tij jane veshur me te gjitha fuqit per drejtimin e zakonshem dhe te jashteza-konshem te shoqerise pa asnje lloj kufizimi. Ai ka mundesi te kryej te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per arritjen e qeelimit te shoqerise. Ai ka te drejte midis te tjerash te bleje e te kembeje pasuri, te lidhet me shoqeri te tjera te vendit ose te huaja , te kryej qdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave private ose shtetore qe kane te bejne me garancite, ipotekat etj. Te kryej prane instituteve bankare e financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa e arketime. Ne keto raste, administratori i ngarkuar ka per detyre te njoftoje dhe t'i jap llogari ortakut te vetem.

#### MARDHENIET E PUNES

#### Neni 14

Mardheniet e punes ne shoqeri regullohen nepermjet kontrates se punes Per qeshtje qe nuk regullohen me kontrate pune, zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

#### Neni 15

Shoqeria merr persiper te respektoje regullat ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore, per te gjitha te punesuarit ne shoqeri, ndersa keta te fundit jane te detyruar te pranojne kete statut.

#### Neni 16

Te gjitha te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes ne shoqeri.

Detyra e ruajtjes se sekretit te punes nga te punesuarit ne shoqeri vazhdon edhe mbas largimit te tyre nga kjo shoqeri.

#### PERFAQESIMI I SHOQERISE

#### Neni 17

Perfaqesimi i shoqerise i perket ortakut te vetem dhe administratorit

*Servet*

te emeruar prej tij. Ai ka te drejten e perfaqesimit te shoqerise ne organet gjyqesore dhe administrative, te caktoje e te pushoje avokat per qdo problem.

### BILANCI DHE TE ARDHURAT

#### Neni 18

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen ne 31 dhjetor te qdo viti.

Ne fund te qdo periudhe ushtrimore, administratori nxierr bilancin kontabel te shoqerise me llogarine FITIM - HUMBJE, mbeshtetur ne ligje e rregulla te mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet private, percaktuar ne ligjin Nr.7651, date 19.01.1993 " Per kontabilitetin" dhe ato te percaktuara nga organet kopetente te sistemit fiskal.

Bilanci kontabel miratohet nga ortakut i vetem, i cili vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per zhvillimin e garancin e veprimtarise se shoqerise, fondin e akumulimit, fondin rezerve etj.

#### Neni 19

Te ardhurat neto, pas veqimit te fondeve ligjore te permendura me sipër dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale nga fitimi , i mbesin per perdorim ortakut te vetem.

### SHPERNDARJA E SHOQERISE

#### Neni 20

Shperberja e shoqerise mund te vije ne qdo kohe dhe per qfardo shkak si, humbja e kapitalit, pamundesi veprimtarie etj. Ne keto raste, ortakut i vetem, vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdatore. Keta bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje me pare detyrimet qe ajo ju ka personave te trete fizik e juridik.

Ne rastin e likujdimit te shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi : SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER.

Mbasi behet njoftimi i mbylljes ose i likujdimit dhe kryhen formalitetet perkatese, shoqeria qregjistrohet nga regjistri tregetar.

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

## Neni 21

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve qe duhet te behen nga ortaku i vetem ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

## Neni 22

Ky statut perpilohet ne disa kopje, me fuqi te barabarte sejcila per t'ju shperndare te gjitha organeve kopetente qe e kerkon ligja, ndersa nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te themelimit te shoqerise.

Statuti hyn ne fuqi dite n e nxierjes se tij nga ortaku themelues i shoqerise, i neneshkruar rregullisht prej tij perpara nje noteri.

ORTAKU I VETEM  
SERVET CAUSHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Nr. 4402 rep.

VERTETIM

Sot, me daten 20.12.2001, ne Dhomen e Noterise Tirane u paraqit Servet Caushi banues ne Levan te Fierit, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili me deklaroi se sa siper eshte hartuar ne perputhje me vullnetin e tij dhe e neneshkroj ate para meje. Sipas ligjit dhe une noterja e vertetoj ate rregullisht.



NOTERE  
NOTERE  
LUNET.

